

Informacion për pjesëmarrjen ne kërkim shkencor te pacientit

Titulli i studimit: Ndikimi i terapisë periodontale jo-kirurgjikale ne diabetin mellitus tipi 2.

Kërkuesi shkencor Dr. Besian Abazi

Institucioni: Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë Tirane

Tirane, 2024

I nderuar pacient,

Pjesëmarrja juaj ne një kërkim shkencor padyshim ndihmon pasurimin e dijeve shkencore dhe zhvillimin profesional te vendit tone. Nëse ju keni dëshirë te merrni pjese është e rëndësishme te lexoni me vëmendje dhe te kuptoni përmbajtjen e kësaj broshure informuese.

Synimi i studimit:

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë nëse trajtimet specifike te mishrave te dhëmbëve do te ndikonin ne përmirësimin e parametrave te sëmundjes se diabetit. Trajtimet specifike nënkuptojnë ndërhyrje jo-kirurgjikale te cilat synojnë pastrimin ne thellësi te mishrave për te eliminuar gurezat dhe papastërtitë e ndryshme te rrezikshme për to. Ky studim kërkon te vlerësojë nëse kjo terapi mund te ndihmoje te përmirësojë vlerat e sëmundjes se diabetit sic është glukoza esëll ose jo dhe hemoglobinën e glukozuar qe ju kryeni rregullisht sipas rekomandimeve te mjekut tuaj. Studimi synon të kontribuojë me njohuri të vlefshme për përmirësimin e shëndit tuaj oral dhe shëndetit tuaj te përgjithshëm.

Çfarë do te ndodhe gjate studimit?

Gjate studimit ju do te kryeni 3 takime për një periudhë 6 mujore duke përfshirë këtu takimin e pare, takimin e dyte pas 3 muajsh dhe takimin e trete pas 3 muajsh te tjerë. Procedurat qe do kryhen janë pastrime te dhëmbëve dhe mishrave te tyre te cilat do vlerësohen para dhe pas procedurave.

Konfidencialiteti:

Konfidencialiteti juaj do të ruhet rreptësishtë. Të gjitha të dhënat e mbledhura do të kodohen për të mbrojtur identitetin tuaj. Emri juaj dhe te dhëna identifikuese nuk do jene te aksesueshme nga pale te tjera. Kërkuesi do të ruajë dhe trajtojë në mënyrë të sigurt të dhënat dhe vetëm kërkuesi do të ketë qasje në to.

Pjesëmarrja Vullnetare:

Pjesëmarrja juaj në këtë studim është tërësisht vullnetare. Ju keni të drejtë të tërhiqeni në çdo kohë pa penalitet. Vendimi juaj nuk do të ndikojë në kujdesin tuaj aktual ose të ardhshëm mjekësor ose marrëdhëniet me studiuesit ose institucionin.